



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11 Qershor 2021

Nr. 403

VENDIM

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj shoqërisë “ALBA GAZ” sh.a
- Kërkues:** Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë
- Ndaj:** “ALBA GAZ” sh.a
- Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neni 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I

Vlerësimi paraprak



Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 1325 prot., datë 13.04.2021, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3703 prot., datë 13.04.2021, nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sekretari i Përgjithshëm zj. Ornela Zonja, është përcjellë denoncimi i mbërritur në mënyrë shkresore pranë këtij institucioni. Në këtë denoncim pretendohet se: *“Punonjësit e shoqërisë ALBA GAZ sh.a, nën mbikëqyrjen e administratorit zotit Arbër Avrami, kanë ngritur dhe mbajnë hapur një zyrë elektorale, në adresën rruga “Hazbi Serani”, Kashar, zona Misto Mame, Kombiant, Tiranë. Ndërkohë bën me dije se zyrat ALBA GAZ sh.a të cilat ndodhen në rrugën e Kosovarëve Tiranë, janë bosh gjatë orarit zyrtar, me pretekstin se punonjësit punojnë nga shtëpia, kur këta të fundit kryejnë aktivitet elektorale në zyrën e sipërpërmendur, në shkelje flagrante me ligjin”.*

Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe nenit 8, të vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në



rastet kur KQZ nuk është organi kompetent dhe/ose nëse mungojnë indiciet e besueshme për të nisur hetimin administrativ, Komisioneri vendos refuzimin për nisjen e hetimit administrativ.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht denoncimin, vlerësoi se mungesa e provave dhe të dhënave, nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesi për shkak se mungojnë indiciet e besueshme për të nisur hetimin administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimit nr. 9 datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Mosfillimin e procedurës administrative për shkak se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljen.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

